



OSHEE GROUP sh.a njofton mbi hapjen e vendit vakant **Specialist i Leximit dhe Menaxhimit të Matjes**.

SPECIALIST I SEKTORIT TË LEXIMIT

Detyrat dhe përgjegjësitë:

- Koordinon dhe mbikqyr ndarjen e zonave të leximit, radhes së leximit me qëllim arritjen e efikasitetit të procesit të leximit
- Kontrollon ngarkesën për lexues sipas llojit të leximit dhe ndarjes gjeografike
- Përgatit evidentimin e leximeve të matësve të bilancit – në nivel Box-i, Kabine, Fider, N/St.
- Përgatit grafikun e leximeve në Nst, Fidera dhe Kabina me qëllim evidentimin e bilancit të energjisë
- Mbikqyr grafikun e leximeve të energjisë së hyrë në rrjet si dhe të gjithë konsumatorëve fundorë dhe siguron respektimin e tij.
- Kontrollon sasinë e konsumave sipas grafikut dhe organizon kontrolle të leximit për konsumatorët me konsume të dyshimta të cilët nuk kanë mbetur në filtrat e leximit.
- Kontrollon cilësinë e leximit nga lexuesit
- Mbikqyr sinkronizimin e leximeve të përcjella në sistemin e evidencave të leximit në mënyrë periodike
- Validon leximet e mbetura në filtrat e leximit, realizimin e kontrollit të këtyre leximeve dhe cilësinë e dokumentacionit për rileximet e realizuara sipas procedurave të miratuara.
- Monitoron dhe ndihmon në bashkëpunim me sektorët e tjerë të menaxhimit matjes për zgjidhjen e anomalive të konstatuara nga lexuesit gjatë procesit të leximit.
- Përgatit dokumentacionet e nevojshme për zgjidhjen e problemeve të leximit si rezultat i keq leximit të kryer nga lexuesit.
- Përgatit disponimin e bazës së nevojshme materiale për lexuesin: PDA, PV për evidentimin e anomalive, minutazh komunikimi, pikat e kontaktit për rastet e evidentimit të cenimit të sistemit të matjes (individual apo kolektiv)
- Kryen kontrolle në terren të anomalive të zgjedhura nga lexuesit.
- Raporton ecurinë e procesit të leximeve dhe grafikut të realizuar
- Evidenton rastet e mosplotesimit të detyrave nga ana e lexuesve dhe propozon masat administrative ndaj tyre tek eprori i drejtëpërdrejtë.
- Monitoron për Zonat e Sherbimit:
 - Ekzekutimin/realizimin e Leximit të matësve të energjisë elektrike bazuar në grafikun e marrë dhe dokumentimin e veprimeve bazuar në procedurën përkatëse
 - Ekzekutimin/realizimin e Kontrollit të Leximit të matësve të energjisë elektrike bazuar në grafikun e marrë dhe dokumentimin e veprimeve bazuar në procedurën përkatëse
- Kontrollon bërjen e energjisë së hyrë në rrjet dhe rakordon të dhënat me specialistin e bilancit
- Aktivitete të tjera, të ngarkuara nga Eprori i drejtëpërdrejtë.

Të gjithë kandidatët e interesuar janë të lutur të bëjnë aplikimin në websiten e OSHEE group, në portalin e punësimit.
Ju njoftojmë se vetëm kandidatët e përzgjedhur do të ftohen për intervistë.